 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNITED NATIONS
ALBANIA



RAPORTI I MONITORIMIT MBI ZBATIMIN E BUXHETIMIT TË PËRGJIGJSHËM GJINOR, FUSHË ARRËZ

**Për gratë e dhunuara dhe në pamundësi dhe të marginalizuara.
Shërbimi social - rrugëtimi drejt fuqizimit**



Leave
No One
Behind

RAPORTI I MONITORIMIT MBI ZBATIMIN E BUXHETIMIT TË PËRGGJIGJSHËM GJINOR, FUSHË ARRËZ

Për gratë e dhunuara dhe në pamundësi dhe të marginalizuara.
Shërbimi social - rrugëtimi drejt fuqizimit

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje.....	5
Raporti.....	7
Metodologjia.....	8
Kufizimet.....	9
Hartimi dhe autorësia.....	9
Kuadri ligjor dhe institucional.....	11
Analiza dhe gjetjet e saj.....	14
Përfundime dhe Rekomandime.....	21

Hyrje

“Merr pjesë, Shprehu, Vendos!” – Rritja e pjesëmarrjes së grave në praktikat e buxhetimit me pjesëmarrje në 15 Bashki 2022 – 2025, zbatohet nga Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, me mbështetjen e UN Women Shqipëri, në kuadër të Pogramit “Askush të mos mbetet pas” (LNB), program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Nën këtë nismë, është krijuar **PRIZMA – Rrjeti i Buxhetimit me Pjesëmarrje**, një rrjetëzim jo formal i organizatave, aktivistëve dhe Bashkive që bashkëveprojnë dhe bashkëpunojnë për përmirësimin e proceseve të buxhetimit me pjesëmarrje në Shqipëri me perspektivë gjinore.

Gjatë ndërhyrjes në 36 Bashki (2018-2024), u bë e mundur të aplikohet modeli i buxhetimit me pjesëmarrje me fokus gjinor duke patur parasysh se cënueshmëria ndërsektoriale e grave mbetet një sfidë:

- Sektorët më kritikë që trajtohen nga gratë si shërbimet sociale, arsimit, punësimi dhe shërbimet shëndetësore, mbeten në pjesën më të madhe, të pa-adresuar ose të nën-buxhetuar në buxhetet e bashkive. Shpesh, në dokumentet e PBA-së të NJQV-ve, programet buxhetore që lidhen me shërbimet sociale, grupet vulnerabël, arsimin etj., renditen në krye si prioritete vendore, por të përkthyer në shifra në buxhet ato mbeten të nënbuxhetuara. Në shumicën e rasteve, buxheti i këtyre programeve përbëhet vetëm nga transfertat përkatëse të qeverisë qendrore.
- Nga ana tjetër, sfida e cënueshmërisë ndërsektoriale nënkupton dhe një perceptim të gabuar si nga burrat ashtu dhe nga gratë që lidhet me lënien jashtë trajtimit gjinor të prioriteteve buxhetore si infrastruktura, investimet kapitale dhe programe të tjera të shërbimeve publike, mjedisore, mbrojtjes nga zjarri, bujqësore etj.

Kursi i veprimit është ndërveprues, gjithëpërfshirës, i bazuar në fakte, metodik dhe lehtësisht i adaptueshëm “Merr pjesë, fol, vendos” arriti të përputhë plotësisht 35% deri 50% të prioriteteve të bashkive me prioritetet e grave, pjesërisht 30% deri 40% e tyre, ndërkohë që 20% deri në 25% e prioriteteve të grave, mbeten të paadresuara për shkak të kapaciteteve të kufizuara teknike dhe financiare, mungesë plane veprimesh, apo për shkak të kopetencave jo të qeverisjes lokale, por është arritur të konsiderohen prioritete për vizionin e Bashkive.

Metodologjia e qasjes, bazuar në ndërhyrjen e mëparshme, fokusohet edhe në vendosjen e bashkëpunimit me bashkitë me qëllim angazhimit të strukturave të tyre, ngritjen e kapaciteteve të tyre në përmirësimin e procesit të buxhetimit me pjesëmarrje, duke përfshirë gratë dhe vajzat dhe të rinjtë, me mbështetjen e organizatave lokale dhe aktivisteve dhe në formulimin e prioriteteve lokale me lente gjinore.

Në këtë kuadër, UN Women dhe “Sot për të Ardhmen” u angazhuan në rritjen e kapaciteteve të rrjetit “PRIZMA” në buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, dhe në rolin e rrjetit në monitorimin e politikave publike kundrejt buxheteve/shpenzimeve publike, si dhe në advokimin më tej për plane, investime dhe shërbime vendore konkrete të buxhetuara.

Në fazën e parë u targetuan 5 bashkitë ku “Merr pjesë, shprehu, vendos” u zbatua, respektivisht bashkitë Gjirokastrë, Delvinë, Dropull, Vau i Dejës dhe Fushë Arrëz. U trajnuan specifikisht për rolin e tyre monitorues sipas një formati të dakortësuar në Rrjetin PRIZMA, anëtarët e rrjetit që punojnë në këto bashki si dhe u përcaktua tematika e raporteve të monitorimit që janë hartuar nga vetë anëtarët e rrjetit PRIZMA, përkatësisht organizata “Qendra Artizaneve Vau i Dejës 2022” për bashkinë Vau i Dejës, organizata “Qendra në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë” (QSNNN) për bashkinë Fushë Arrëz, Universiteti “Eqerem Cabej”, Save the Children, Aleanca e grave Keshilltare për Bashkinë Gjirokastrë, Estia Dropull, Shoqata kulturore Dropull dhe Universiteti “Eqerem Cabej” për Bashkinë Dropull, Aleanca e Grave Keshilltare dhe Universiteti “Eqerem Cabej” për Bashkinë Delvinë. Organizatat përcaktuan fillimisht fushën dhe

drejtimet që konsiderojnë për të realizuar monitorimin dhe përgatitjen e raporteve watchdog (monitorimi) të programeve dhe shërbimeve të bashkive perkatese, duke u mbështetur në çështje të ngritura gjatë konsultimeve me gra dhe vajza dhe të adresuara nga organizatat në këto bashki.

Fusha e përzgjedhur për 5 bashkitë dhe tematika e dakortësuar për raportet e monitorimit

Vau i Dejës:

Shërbimet sociale gjithëpërfshirëse për gratë dhe vajzat

- për gratë e dhunuara dhe në pamundësi punësimi dhe të marginalizuara
- Shërbimi social - rrugëtimi drejt fuqizimit ekonomik

Vau i Dejës:

Shërbimet sociale gjithëpërfshirëse për gratë dhe vajzat

- për gratë e dhunuara dhe në pamundësi punësimi dhe të marginalizuara
- Shërbimi social - rrugëtimi drejt fuqizimit ekonomik

Gjirokastrë:

Shërbimet sociale gjithëpërfshirëse për gratë dhe vajzat

- Ndergjegjësimi i grave dhe vajzave të komunitetit Rom/ Egyptian në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës

Dropull:

Shërbimet sociale gjithëpërfshirëse për gratë dhe vajzat

- Fuqizimi i shoqërisë civile në funksion/mbështetje të promovimit të artit dhe kulturës (përfshirjes së grave, fëmijëve dhe të rinjve)

Delvinë:

Shërbimet sociale gjithëpërfshirëse për gratë dhe vajzat

- Përkujdesja sociale për të moshuarit, gratë me aftësi të kufizuar dhe gratë kujdestare

Raporti

Ky raport analizon planifikimin dhe zbatimin e shpenzimeve totale për mbrojtjen sociale në bashkinë Fushë-Arrëz, duke u fokusuar kryesisht në zbatimin e buxhetimit të *përgjigjshëm gjinor, në programin e kujdesit social për familjet dhe fëmijët, kujdesin social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara, të moshuarit, strehimin social, papunësinë dhe programin e arsimit dhe aftësisimit.*

Në kuadër të objektivave strategjike të reformës administrative – territoriale , miratuar në Korrik të vitit 2014, bashkitë kanë marr rolin kryesor në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët në nivel vendor. Neni 24 i Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton përgjegjësitë e NJVQV në fushën e shërbimeve sociale. Ato lidhen kryesisht me shpërndarjen e ndihmës ekonomike, me ofrimin e disa lehtësive financiare për grupet vulnerable (p.sh. ulja e çmimit në disa shërbime si transporti publik), por dhe me administrimin e qendrave sociale ose me hapjen e qendrave të reja dhe ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë kryefamiljare, viktimat e trafikimit etj .

Vitet e fundit ka gjithashtu një interes në rritje nga ana e bashkive për t’u bërë pjesë e iniciativave për zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, me synimin që programet buxhetore të marrin në konsideratë nevojat e burrave dhe grave, djemëve dhe vajzave, të sigurojnë që buxheti vendor të kontribuojë në zvogëlimin e pabarazive dhe të ofrojë shërbime publike që mundësojnë fuqizimin e tyre.. Masat e miratuara për adresimin e nevojave në këtë fushë kanë bërë që shumë NJVQV të marrin në konsideratë planifikimin e burimeve të nevojshme financiare dhe përdorimin me efektivitet të shpenzimeve në dobi të grupeve në nevojë. Bashkia Fushë-Arrëz ka miratuar një dokument të rëndësishëm ku identifikohen nevojat dhe adresohen prioritetet në fushën e kujdesit social (Plani Social 2021-2023).

Mbrojtja dhe fuqizimi i grupeve në nevojë përfshihet gjithashtu dhe në disa strategji dhe plane kombëtare si Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2019-2022, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Plani Kombëtar i veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, etj.

Shpenzimet buxhetore mund të jenë në formën e shpenzimeve me përfitim direkt për familjet siç janë përfitimet në para për aftësinë kufizuar dhe ndihmën ekonomike. Por këto grupe mund të përfitojnë gjithashtu në mënyrë indirekte nga shërbimet që ofrohen në nivel komuniteti dhe në mënyrë indirekte nga investimet e ndryshme që realizohen në territorin e bashkisë, etj. Në raport janë analizuar të gjitha shpenzimet e planifikuara dhe realizuara në fushën e mbrojtjes sociale , duke mbajtur në konsideratë nevojat e identifikuar nga perspektiva gjinore.

Bazuar në sa më sipër, objektivi kryesor i këtij raporti është të vlerësojë shkallën e shpenzimeve të realizuara gjatë vitit 2022 dhe shpenzimet e planifikuara për vitin 2023 për shërbimet sociale për grupet vulnerabël, kryesisht gratë e dhunuara, të identifikojë nivelin e arritjeve si edhe të ngrejë çështjet më problematike të kësaj fushe në drejtim të strukturave shtetërore në nivel vendor. Në mënyrë të përmbledhur si objektiva të raportit të monitorimit mund të përmendim:

- Të analizojë ndarjen e shpenzimeve në fushën e shërbimeve sociale lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale për gratë e dhunuara dhe kategoritë e tjera vulnerabël;
- Të evidentojë në mënyrë krahasimore ndarjen e shpenzimeve sociale për vitet 2022 dhe 2023 me qëllim evidentimin e progresit në terma të barazisë gjinore
- Të eksplorojë nivelin e plotësimit të detyrimeve strategjike në fushën e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor me qëllim ofrimin e shërbimeve të kujdesit social për gratë e dhunuara në drejtim të përmirësimit të jetës së tyre dhe integrimin në shoqëri;

- Të identifikojë problemet praktike në fushën e mbledhjes dhe analizës së të dhënave mbi shpenzimet buxhetore të ndara sipas gjinisë.
- Të ofrojë rekomandime konkrete mbi rritjen e proaktivitetit të Bashkisë në drejtim të zbatimit të detyrimeve për hartimin e buxheteve të përgjigjshme gjinore si dhe buxhetimin e masave me rëndësi për përmirësimin e situatës së barazisë gjinore në vend dhe rritjen e aksesit të grave në sferën e shërbimeve sociale

Për realizimin e objektivave të sipërshtuara, **raporti është fokusuar kryesisht në çështjet e mëposhtme:**

- Analizën e prirjeve të shpenzimeve buxhetore për programet që targetojnë personat me aftësi të kufizuara, familjet e varfëra, viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, fëmijët në përgjithësi dhe fëmijët me AK etj.
- Analizën nga perspektiva gjinore e shpenzimeve buxhetore të lidhura me grupet në nevojë, duke përfshirë: planifikimin e fondeve publike për të realizuar të drejtat e tyre; sa buxheti vendor merr parasysh nevojat e kategorive vulnerabël si gratë viktimat të dhunës në familje, si edhe rolin që këto grupe kanë në buxhetimin me pjesëmarrje, transparencën dhe llogaridhënien.
- Analizën e përputhshmërisë së politikave në fushën e mbrojtjes sociale dhe buxhetit afatmesëm për zbatimin e këtyre politikave.

Metodologjia

Për realizimin e këtij studimi u përdorën disa metoda ku përfshihet:

- Grumbullimi i të dhënave statistikore për treguesit e performancës për qëllimin dhe objektivat e programeve buxhetore, mbështetur kryesisht në statistikat e bashkisë, statistika të publikuara nga INSTAT, raportet e monitorimit të programeve buxhetore dhe raporte alternative;
- Analiza e kuadrit ligjor dhe strategjik në fuqi për mbështetjen me shërbime të kujdesit shoqëror për gratë dhe vajzat viktimat të dhunës;
- Shqyrtimi i literaturës ku përfshihet analiza me perspektivën gjinore e dokumentacionit bazë vendor, kombëtar dhe sektorial që shënjestron problematikat në fushën e mbrojtjes sociale të cilat shërbejnë si dokumenta politikë bazë për hartimin e buxhetit vendor;
- Grumbullimi i të dhënave financiare mbështetur në bazën ligjore dhe dokumentacionin që lidhet me buxhetin vendor si: Udhëzimi vjetor i PBA-së së NJQV-ve, Udhëzimi nr.20, datë 09.07.2021 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, Instrumenti i Planifikimit Financiar, vendimet e KB, relacionet e buxhetit, raportet e monitorimit;
- Takime informuese me punonjësit e Bashkisë së Fushë-Arrëzit që janë përgjegjës për mbrojtjen dhe çështjet sociale;
- Informacione dhe të dhëna nga zyra e punës Pukë;
- Të dhëna të marra nga dokumentet zyrtare të publikuara në faqen zyrtare të insitucionit <https://www.bashkiafushearrez.gov.al>

Raporti synon të analizojë buxhetin vendor në fushën e mbrojtjes sociale, duke mbajtur në konsideratë se si programet buxhetore reflektojnë nevojat vendore nga perspektiva gjinore. Raporti analizon gjithashtu boshllëqet në sistemin e mbrojtjes sociale dhe procedurat që mund të pengojnë dhe/apo shtrembërojnë zbatimin e masave në bashkinë Fushë – Arrëz.

Analiza e shpenzimeve buxhetore do të fokusohet në programin e kujdesit social për familjet dhe fëmijët, kujdesin social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara, strehimin social, papunësinë, arsimin dhe aftësimin, të cilat konsiderohen si programe me ndikimin direkt më të madh në jetën dhe mirëqënien e grave dhe vajzave viktime të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Kufizimet

Një ndër kufizimet me kryesore që ka vështirësuar ofrimin e një analize të plotë është mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë për produktet buxhetore që lidhen me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Mungesa e të dhënave të ndara e ka bërë të pamundur gjurmimin e shpenzimeve buxhetore në terma të përfituesve. Për më tepër, analiza në këtë bashki ka qenë e kufizuar edhe për shkak të mungesës së produkteve buxhetore të ndjeshme gjinore, objektivave dhe treguesve të ndjeshëm gjinore.

Në terma të dokumentacionit të buxhetit, buxheti i 2023 nuk disponohet në faqen zyrtare të bashkisë Fushë Arrëz edhe pse viti buxhetor është në përfundim të tij. Mungojnë gjithashtu të shënat lidhur me raportet e monitorimit dhe realizimit të buxhetit për vitin 2022 dhe raportet e ndërmjetme për realizimin e buxhetit 2023.

Sa më sipër, analiza është përqënduar kryesisht në krahasimin e shpenzimeve buxhetore për programet buxhetore në tërësi, duke mos arritur dot të evidentohen analiza në terma të produkteve dhe shpenzimeve për barazinë gjinore dhe shërbimet e dedikuara për gratë dhe vajzat viktime të dhunës.

Hartimi dhe autorësia:

Zhvillimi i këtij raporti u ndërmor nga Shoqata “Qendra Sociale në Ndhimë të Njerezeve në Nevoje” Fushë-Arrëz (QSNNN), znj. Daniela Ymeri. Përpjekja e bashkëpunimit përfshinte angazhimin me zyrtarë nga Bashkia Fushë Arrëz dhe anëtarët e komunitetit lokal.

Sfondi historik

2.1 Përshkrimi i shkurtër i bashkisë

Bashkia Fushë Arrëz bën pjesë në Qarkun Shkodër. Ka një sipërfaqe prej 540 km² dhe përbëhet nga pesë njësi administrative: Fushë Arrëz, Fierzë, Blerim, Qafë-Mali dhe Iballë.

Qendra e Bashkisë është qyteti i Fushë Arrëzit dhe në përbërjen e 5 njësive administrative janë 30 fshatra. Njësia administrative më e afërt me qendrën e Bashkisë është Qafa e Malit, ndërsa njësitë e tjera administrative janë në distanca nga 1-3 orë larg saj. Fshatrat gjithashtu janë në distanca edhe më të largëta. Shtrirja gjeografike është një element i rëndësishëm që do të mbahet në konsideratë në planifikimin e shërbimeve.

Të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të prillit 2020 japin një numër popullsie prej 11,388 banorësh në 3,990 familje. Censusi i vitit 2011 jep një numër popullsie prej 7,405 banorësh për Bashkinë Fushë Arrëz, pra 65% e popullsisë së regjistruar në gjendjen civile jetonin fizikisht në këtë Bashki.

Tabela 1: Të dhëna mbi popullsinë

Njësia Administrative	Numri Popullsisë	Numri Familjeve	Popullsia sipas grup moshave				
			0-6 vjeç	7-15 vjeç	16-18 vjeç	19-64 vjeç	65+ vjeç
Fushë Arrëz, Qafë Mali, Blerim	7 770	2 727	492	859	300	5 253	866
Iballë	1 706	619	102	194	97	1 093	220
Fierzë	1 912	644	139	231	91	1 166	285
TOTALI	11 388	3 990	733	1 284	488	7 512	1 371

Individë në nevojë për shërbime sipas të dhënave statistikore dhe josatistikore

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe analizuar në nivel bashkie, rezultojnë se 2,487 banorë të Bashkisë Fushë Arrëz kanë të nevojshëm të paktën një nga format e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ata përbëjnë 21,8% të popullsisë së kësaj Bashkie. Numrin më të lartë të individëve në nevojë për shërbime e gjejmë në familjet përfituese të ndihmës ekonomike, si dhe tek personat me aftësi të kufizuara.

Tabela 2. Përmbledhje e individëve në nevojë për shërbime të identifikuara në raport me numrin e popullsisë së arritur në këto shifra.

Njësia Administrative	Numri Popullsisë	Nr. individë në nevojë për shërbime kujdesi shoqëror	%
Fushë Arrëz		562	
Qafë Mali	7,770	422	16,5%
Blerim		302	
Iballë	1,706	504	29,5%
Fierzë	1,912	697	36,4%
TOTALI BASHKI	11,388	2,487	21,8%

Viktima të dhunës në familje

Duke qenë se fokusi i këtij raporti është monitorimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në Bashkinë Fushë Arrëz në drejtim të buxhetimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, e çmuam me rëndësi prezantimin në raport të disa të dhënave referuar kësaj kategorie. Kështu, nisur nga analiza e bërë në nivel bashkie rezultojnë se niveli i raportimit të dhunës në familje në Bashkinë Fushë-Arrëz është shumë i ulët. Në analizë krahasimore, duke filluar nga vitin 2018 konstatohet so më poshtë vijon:

- Për vitin 2018 nuk është raportuar asnjë rast i dhunës në familje;
- vitin 2019 Bashkia raporton një rast dhune në familje në njësinë administrative Qafë Mali.

- Në total nga viti 2018 -2021 janë raportuar 5 raste dhune të cilat janë mbeështetur nga UNDP me shërbim psikologjik, ligjor etj. Për 1 nga rastet e dhunës, konkretisht gruaja e dhunuar është transferuar në bashkinë Shkodër për strehim tek “Gruaja tek gruaja”.
- Nga viti 2021 e në vazhdim ka mungesë të raportimit të rasteve të dhunës. Gjithashtu, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore nuk ka qenë gjatë kësaj periudhe identifikimi në terren i rasteve të dhunës e për rrjedhojë dhe të ofrimit të shërbimeve specifike.

Numri i kufizuar i rasteve të dhunës lidhet me mos raportimin e dhunës, si dhe mungesën e informimit të komunitetit se ku dhe si ta denoncojnë atë. Për rrjedhojë është i nevojshëm jo vetëm ndërgjegjësim dhe informim më i gjerë, por edhe identifikim proaktiv i rasteve dhe ndërveprim i vazhdueshëm me aktorë publik e jopublik që kanë detyrime ligjore në këndvështrimin e masave kundër dhunës në familje.

Kuadri ligjor dhe institucional

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 24 ka përcaktuar funksionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale dhe specifikt: (1) Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror, e krijuar pranë Bashkisë, duhet të sigurojë: drejtimin strategjik, planifikimin, ngritjen, funksionimin, financimin, monitorimin dhe mbështetjen me kapacitete të sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ndërkohë kjo strukturë kryen dhe funksione që lidhen me administrimin e pagesave cash të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, sikurse në përputhje me VKM Nr.334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” ka në përbërje të saj edhe koordinatoren vendor për adresimin e dhunës në familje.

Në përputhje me Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, pjesë e kësaj strukture është edhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, e cila ushtron rolet dhe funksione që rrjedhin nga ky ligj. “Qendra Sociale në Ndhim të Njerëzve në Nevojë” është e vetmja qendër jo publike në territorin e njësisë administrative Fushë Arrëz që ofron shërbime komunitare, kryesisht këshillime për familjet, evente festash, vakte ushqimore. Në qendër ofrohen shërbime të konsulencës juridike dhe psikologjike. Kjo qendër ka zbatuar një projekt për punësimin e grave në kuadër të të cilit 5 gra u trajnuan dhe punojnë për mbledhjen e bimëve medicinale, gjë e cila u ka përmirësuar kushtet e jetesës për vete dhe familjet e tyre.

Në terma të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore burojnë detyrime ligjore dhe strategjike.

Në nivel strategjik, buxheti i përgjigjshëm gjinor është pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2021- 2030, duke u vendosur në këtë mënyrë në strategjinë ombrellë të të gjithë kuadrit strategjik në Shqipëri. Në harmonizim me SKZHI, koncepti i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në nivel vendor është përkthyer në objektiva specifike dhe masa si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Konkretisht, Qëllimi strategjik IV i kësaj strategjie “Aplikimi i integritimit gjinor si mjet për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri parashikon një objektiv specifik të lidhur me zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në nivel vendor:

Objektivi specifik IV 3: Mbështetja e Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore për njohjen dhe zbatimin e detyrimit ligjor për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Për arritjen e objektivit të mësipërm, SKBGj 2021-2030 ka detajuar në planin e saj të veprimit masat konkrete për t'u zbatuar nga njësitë e qeverisjes vendore me qëllim që buxhetet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të reflektojnë zbatimin korrekt të legjislacionit mbi aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Referuar kuadrit ligjor për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në nivel vendor, baza kryesore ligjore për hartimin e BPGJ është ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” është përcaktuar se ligji ka për qëllim të sigurojë që në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare vendore të njësive të vetëqeverisjes vendore **përshejtohet dhe realizohet barazia gjinore**. Në përputhje me këtë parim, të gjitha programet buxhetore, aty ku është e mundur, duhet të përcaktojnë të paktën një objektiv me bazë gjinore të shoqëruar me tregues performance respektive në nivel objektiv dhe produkti.

Gjithashtu, në pikën 4 të nenit 36 “Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor”, përcaktohet se PBA përfshin informacion për qëllimet e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre përkatëse. Sipas shkronjës c të kësaj pike “**të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore.**”¹

Në terma të hartimit të raporteve të monitorimit, nenin 54 i ligjit nr.68/2017 “Raportimi financiar”, parashikon në mënyrë specifike se treguesit financiarë që publikohen, përfshijnë por nuk kufizohen në raportin e shpenzimeve për politikën që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme.

Bazuar në ligjin nr. **ligji nr.68/2017, Ministria përgjegjëse për çështjet e financave ka hartuar udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”**. Në pjesën e parë të udhëzimit “Të përgjithshme” përcaktohet si më poshtë:

*“Qëllimet e politikës të programit, objektivat e politikës së programeve, produktet e programeve dhe kostot përkatëse, shoqëruar me treguesit e performancës. **Të paktën një nga objektivat e politikave sipas programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore**”*

Ky udhëzim përcakton edhe përgjegjësitë e Kryetarit të njësive të vetëqeverisjes vendore lidhur me buxhetimin me bazë gjinore. Kështu, Kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore në rolin e kryetarit të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), ka përgjegjësinë të drejtë, koordinon GMS dhe të garantojë pjesëmarrjen e drejtuesit të çdo programi buxhetor, në seancat dëgjimore të buxhetit të organizuara me komunitetin. Gjithashtu, në këtë rol ai ka si përgjegjësi :

- Të japë udhëzime në lidhje me identifikimin e qëllimeve, objektivave të politikës së programit për të gjithë drejtuesit e programeve, duke siguruar që për çdo program respektohet barazia gjinore ose promovimi i saj;
- Të kërkojë nga drejtuesit e programeve që të evidentojnë, mbledhin dhe administrojnë të dhëna sipas gjinisë në mënyrë që të planifikohen qëllimet dhe objektivat me bazë gjinore si dhe për të matur progresin në lidhje me to.

Në pikën 38 të udhëzimit, përcaktohet në mënyrë specifike, se Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programit janë përgjegjës për:

1 Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Neni 36, pika 4/ c

f. Përcaktimin për programin buxhetor në përgjegjësinë e tyre të minimalisht një qëllimi të politikës që adreson respektimin e plotë të barazisë gjinore ose promovon barazinë gjinore në fushën/sectorin përkatës. Aty ku gjykohet e aplikueshme, të përcaktojnë objektiva konkretë me bazë gjinore të shoqëruara me tregues të përshtatshëm dhe të matshëm performance, ku do të synohet që të identifikohet një ose disa produkte me kostot përkatëse që do të kontribuojnë në realizimin e tyre;

Shtojca nr.4 e udhëzimit përmban një informacion të detajuar për buxhetimin gjinor në njësitë e vetëqeverisjes vendore duke parashikuar se në përputhje me parimin e barazisë gjinore të përcaktuar në ligjin Nr. 68, datë Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të gjitha programet buxhetore në njësitë e qeverisjes vendore, aty ku është e mundur, duhet të përcaktojnë të paktën një objektiv me bazë gjinore të shoqëruar me tregues performance respektive në nivel objektiv dhe produkti. Gjithashtu, në këtë shtojcë parashikohet se “aty ku është e aplikueshme, programet buxhetore duhet të përcaktojnë apo reflektojnë qëllime të politikës në përputhje të plotë me:

- qëllimet strategjike të arritjes së barazisë gjinore të përcaktuara në SKZHI, strategjitë sektoriale vendore;
- planet e zhvillimit vendor;
- udhëzimet e Kryetarit të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore;
- udhëzimet e Këshillit të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore.

Në kuadër të përgatitjes së raporteve të monitorimit, **Udhëzimi nr.22 datë 30.07.2022 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”** parashikon në shtojcën 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” se relacioni shpjegues për çdo format duhet të përfshijë ecurinë e realizimit të qëllimeve, dhe objektivat e politikës që trajtojnë çështjen e barazisë gjinore nëpërmjet treguesve të performancës.

Bazuar në detyrimet e sipërcituara vlen të nënvizojmë se hartimi i buxheteve të përgjigjshme gjinore nuk është vetëm i lidhur me vullnetin e Bashkisë Fushë Arrëz, por gjithashtu një detyrim ligjor që duhet të merret parasysh në çdo fazë gjatë hartimit të programeve buxhetore.

Plani Vendor Social i Bashkisë Fushë-Arrëz

Detyrimet për planifikimin e shpenzimeve buxhetore të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për të gjitha kategoritë vulnerabël, përfshirë gratë dhe vajzat e dhunuara reflektohet edhe në Planin Social Vendor 2022-2024.

Misioni i Bashkisë Fushë Arrëz në terma të Planit Social është garantimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror me cilësi të lartë në partneritet me OJQ-të dhe sektorin privat për të përmirësuar jetën e çdo individit në situatë të pafavorshme, të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

Parimet kryesore në të cilat bazohet Plani Social Vendor 2022-2024 i bashkisë Fushë Arrëz janë : barazia gjinore dhe mosdiskriminimi, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore, drejtësia social si edhe universaliteti i mbulimit me shërbime të kujdesit shoqëror.

Në kuadër të ofrimit të shërbimeve shoqërore për viktimat e dhunës në familje, në lëtë plan konstatohet se nuk **egziston asnjë shërbim kujdesi shoqëror për viktimat e dhunës në familje** në Bashkinë Fushë Arrëz.


Që prej tetorit 2019 UNDP ka mbështetur Bashkinë Fushë Arrëz për ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit ndërsektorial kundër dhunës në familje. Analiza e nevojave ka treguar se për funksionimin normal të Mekanizmit është e nevojshme parashikimi dhe planifikimi i shpenzimeve buxhetore për rritjen e kapaciteteve të Mekanizmit të Referimit sie dhe planifikimi i aktiviteteve ndërjegjësuere me qëllim parandalimin dhe raportimin e rasteve të dhunës.

Analiza dhe gjetjet e saj

Të ardhurat dhe shpenzimet nga perspektiva afatmesme

Figura 1 paraqet të ardhurat dhe shpenzimet e bashkisë për periudhën 2018-2023. Nga figurë vihet re që të ardhurat dhe shpenzimet e bashkisë planifikohen me ndryshime shumë të vogla për të gjithë periudhën 2021-2023. Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë do të rriten me 3%; Të ardhurat nga burimet e veta do të rriten me 1.4%. Bashkia Fushë – Arrëz është shumë pak aktive dhe në terheqjen e projekteve nga donatore ndërkombetare, me qëllim përmirësimin e performances në ofrimin e shërbime sociale.

Figura 1: Të ardhurat dhe shpenzimet e bashkisë Fushë Arrëz



Burimi: Buxheti për qytetarin 2020-2023

Të ardhurat nga burimet e veta zënë mesatarisht 10.0% të të ardhurave totale për të gjithë periudhën 2020-2023, ndërsa të ardhurat nga buxheti qendror për të njëjtën periudhë (transferta e kushtëzuar, transfera e pakushtëzuar dhe transfera specifike) zënë afërsisht 90.0% të të ardhurave totale. Pjesën më të madhe të të ardhurave bashkia e siguron nga transfera e qeverisë qendrore.

Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë Fushë – Arrëz janë rritur me 3% gjatë periudhës 2020-2023. Bashkia Fushë – Arrëz është shumë pak aktive dhe në terheqjen e projekteve nga donatore ndërkombetare, me qëllim përmirësimin e performances në ofrimin e shërbime sociale.

Figura 2: Të ardhurat sipas burimeve të financimit në %





Tabela 3 paraqet të ardhurat nga buxheti qendror sipas llojit të transferëts. Siç mund të shihet nga tabela transferta e pakushtëzuar zë 31.7% të transfertës së përgjithshme, dhe kjo tregon njëvarësi të madhe që ka bashkia nga të ardhurat që merr nga qeveria qendrore. Kjo varësi e madhe nga të ardhurat nga buxheti qendror vështirëson financimin e politikave të reja nga ana e bashkisë dhe nuk mundëson që bashkia të rrisë në masë të konsiderueshme shpenzimet për funksionin e mbrojtjes sociale. E vetmja mënyrë për të rritur shpenzimet e këtij programi është rialokimi i shpenzimeve midis programeve buxhetore.

Tabela 3. Të ardhurat nga buxheti qendror (në 000/lekë)

Të ardhura nga buxheti qendror	2020	2021	2022	2023
Transferta e kushtëzuar	94,681	97,778	97,779	97,779
Transferta e pakushtëzuar	77,686	79,240	79,713	85,709
Transferta specifike	75,503	79,171	75,503	76,447
Totali i transfertës	247,870	256,189	252,995	259,935
Totali i transfertës së pakushtëzuar në % ndaj totalit	31.3%	30.9%	31.5%	33.0%

Burimi: Buxheti për qytetarin 2020-2023

Niveli i të ardhurave që planifikohet nga burimet e veta tregon që Bashkia Fushë-Arrëz megjithëse ka burime natyrore dhe potenciale për zhvillim ekonomik, ka qëndrueshmëri financiare të ulët. Të ardhurat nga burimet e veta nëpërmjet taksave, tarifave, të ardhurave të tjera nga renta minerare, asetet dhe donacionet nuk i japin mundësi për të zgjeruar shërbimet për komunitetin. Gjithashtu Bashkia Fushë – Arrëz paraqet performancë të dobët dhe në mbledhjen e të ardhurave të planifikuara.

Figura 3: Shpenzime në përqindje sipas funksioneve 2022**Burimi:** Buxheti për qytetarin 2020-2023

Peshën më të madhe në shpenzimet e bashkisë e ka programi “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”. Për vitin 2022 shpenzimet për këtë program janë sa 35.2% e shpenzimeve totale.


Në terma të kategorive vulnerabël, Bashkia Fushë Arrëz ka planifikuar shpenzime për ofrimin e përfitimeve në para dhe natyrë për familjet që kanë fëmijë në kujdestari, shpenzimet për jetimore, familje kujdestare, personat plotësisht ose pjesërisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi, të paaftë për veprimtari ekonomike etj, shpenzimet për mbulimin e shërbimit të çerdheve, etj.

Në dokumentin “Buxheti për qytetarin 2020-2023” nuk evidentohen shpenzime për nënfunksione të tjera të “Mbrojtjes sociale” siç janë strehimi social apo papunësia, problematikë kryesore e raportuar në shume takime sidomos me gratë.

Analiza e programeve buxhetore me lente gjinore

Në këtë pjesë të raportit analizohet buxheti vendor në fushën e mbrojtjes sociale, duke mbajtur në konsideratë vetëm programet buxhetore që duhet të reflektojnë nevojat nga perspektiva gjinore. Analiza përqëndrohet vetëm në shpenzimeve buxhetore të programit të kujdesit social për familjet dhe fëmijët, pasi për programet e tjera nuk ka shpenzime të planifikuara.

Figura 4 paraqet shpenzimet për nënfunkcionin “Shpenzimet e kujdesit social për familjet dhe fëmijët” kundrejt shpenzimeve totale. Shpenzimet për këtë program zënë rreth 1/3 e shpenzimeve totale dhe janë planifikuar më një rënie të lehtë për vitin 2022. Shpenzimet e planifikuara për këtë nënfunkcion, me përjashtim të pagesave në cash, **nuk reflektojnë shpenzime** për shërbime të dedikuara për grupet në risk dhe në terren konstatohet mungesë e ofertës për shërbimeve sociale sipas parashikimeve të ligjit. “Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë” është e vetmja qendër jo publike në territorin e njësisë administrative Fushë Arrëz që ofron shërbime komunitare, kryesisht këshillime për familjet, evente festash, vakte ushqimore. Në qendër ofrohen shërbime të konsulencës juridike dhe psikologjike.

Figura 3: Shpenzimet për kujdesin social ndaj shpenzimeve totale

Burimi: Buxheti për qytetarin 2020-2023

Tabela 4. paraqet më poshte disa nga treguesit e programit buxhetor “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”. Treguesit na japin informacion për numrin e personave që përfitojnë në skemën e ndihmës ekonomike, persona që përfitojnë pagesë paaftësie dhe invaliditeti dhe numri i fëmijëve që shërbehen në kopshte dhe çerdhe. Shifrat e paraqitura në këtë tabelë tregojnë që treguesit nuk ndryshojnë për të gjithë periudhën dhe ato nuk kanë ndjeshmëri gjinore (sidomos përfituesit në NE dhe personat e trajtuar me pagesë paaftësie). Shpenzimet për investime për këtë program buxhetor janë zero.

Tabela 4. Përfituesit sipas programeve (2019-2023)

Viti	Persona të trajtuar me pagesë paaftësie dhe invaliditeti	Persona të trajtuar me NE	Numri i çerdheve dhe kopshteve	Numri fëmijëve të shërbyer në kopshte dhe çerdhe
2019	507	451	6	68
2020	520	480	6	68
2021	520	480	6	68
2022	520	480	6	68
2023	520	480	6	68

Burimi: Buxheti për qytetarin 2020-2023

Nga analiza që i bëmë këtij programi buxhetore konstatuam që si objektivat dhe treguesit për matjen e tyre nuk kanë ndjeshmëri gjinore.

Plan Buxheti 2023 – Bashkia Fushë – Arrëz – Reflektime të prioriteteve të grave dhe të rinjve

Një risi këtë vit është organizimi i dëgjesave publike me grupe të grave, me QSNNN si pjesë e rrjetëzimit PRIZMA që ka si qëllim përmirësimin e proceseve të buxhetimit me pjesëmarrje dhe fuqizimin e grave dhe të rinjve në diskutimin e prioriteteve lokale, me mbështetjen e UN Women.

- 56 gra dhe të rinj u aktivizuan, edukuan dhe fuqizuan për të shprehur prioritete lokale, të cilat në konsultim me bashkinë u analizuan më tej.
- 22 përfaqësues të grave, të rinjve dhe burrave si dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak organizuan një dëgjesë të përbashkët për të paraqitur çështjet e nxjerra nga konsultimet publike me grupet e grave dhe të rinjve.

Ndër çështje të drejtpërdrejta të ngritura nga gratë dhe të rinjtë dhe që u parashtruan te anëtarët e këshillit bashkiak janë:

1. Infrastruktura – investime në rrugët e qytetit, sidomos në zonën e pallateve
2. Shërbime publike – Ndricimi i rrugëve
3. Investime – rehabilitimi nga pasojat e tërmetit në ndërtesa / pallatet e reja, catitë
4. Sociale – Ngritja e një qendre multifunkionale
5. Sociale – Krijimi i një parku lojrash për fëmijët
6. Arsimit, kulturë – krijimi i një biblioteke, aktivitete kulturore
7. Nxitja e punësimit nëpërmjet zhvillimit të start-up-ve me fokus te gratë dhe të rinjtë
8. Nxitja e bashkëpunimit me zyrën e punës Pukë
9. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve urbane, ruajtja e mjedisit

Mbeten prioritare:

1. Sociale – Ngritja e një qendre multifunkionale
2. Investime – rehabilitimi nga pasojat e tërmetit në ndërtesa / pallatet e reja, catitë
3. Infrastruktura – investime në rrugët e qytetit, sidomos në zonën e pallateve

67% e prioriteteve të ngritura janë adresuar në prioritetet e bashkisë, ndërsa pjesa tjetër mbeten prioritete, për të cilat bashkia do përqendrohet në periudhën afatmesme dhe/ose në financime të tjera.

Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin e Çështjeve (NECRU) - shërbim për komunitetin (EU4Municipalities)

Rikonstruksioni i qendrës multifunkionale, e cila do të ofrojë shërbime ndaj grupeve të marginalizuara dhe vulnerabël në Bashkinë Fushë Arrëz.

Rezultatet Kryesore

1. Qendra multifunkionale e krijuar në Bashkinë Fushë Arrëz lehtëson një qasje gjithëpërfshirëse për kuotat gjinore dhe një dimension social për rreth 60 persona nga grupet e marginalizuara dhe vulnerabël:
 - 30 persona me aftësi të kufizuara (disabilities);
 - 10 persona me te ardhura të ulta ekonomike;
 - 20 persona me nevoja që përfshijnë katogritë: të rinj të marginalizuar, të moshuar, gra të abuzuara, individë të marginalizuar prej komunitetit romë etj.
2. Një punonjës social i punësuar në Bashkinë Fushë Arrëz, 5 persona nga Sektori i Kujdesit Social si dhe nga 1 person prej secilës njësi administrative, janë më të aftësuar për t'u shërbyer grupeve të marginalizuara dhe vulnerabël; shërbimi do të jetë i disponueshëm online.

Përmbledhje e problematikave të evidentuara në bashkinë Fushë Arrëz lidhur me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor

Nga analiza e realizuar për efekt të këtij raporti vihet re mungesa e planifikimit të shpenzimeve buxhetore të nevojshme për realizimin e nevojave të viktimave të dhunës për shërbime të kujdesit shoqëror. Arsyet e mungesës së shpenzimeve të dedikuara për këtë kategori lidhen së pari me buxhetin e kufizuar që disponon bashkia Fushë Arrëz. Gjithashtu, një tjetër problematikë lidhet me mungesën e burimeve njerëzore, çka e bën shumë të vështirë për popullsinë marrjen e shërbimeve specifike me ndjeshmëri gjinore. Ajo që vihet re në këtë Bashki të nivelit të tretë, është që numri më i madh i individëve të papunësuar janë gra dhe vajza, të cilat duke qenë se përballen edhe me mentalitetin e fortë të zonës, janë më pak të prirura të punësohen gjatë sezonit turistik, psh. të punësohen në hoteleri në bregdet siç ndodh me djemtë e ri të zonës, të cilët largohen për të punuar 3 - 4 muaj në zonat bregdetare të Shqipërisë.

Mungesa e fondeve në nivel të qeverisë dhe donatorëve të huaj, për shkak edhe të numrit të vogël të popullsisë, bën që komuniteti i kësaj bashkie të përballet jo vetëm me mungesën e shërbimeve sociale, por edhe me mungesën e infrastrukturës sidomos në zonat rurale, ku ka mungesë të theksuar urash apo rrugësh dytësore, çka bën shumë herë më të vështirë jetesën e banorëve e sidomos të grave në zonë. Edhe pse si burrat ashtu edhe gratë janë të prekur në mënyrë direkte nga mungesa e infrastrukturës, gratë janë më të prekura për shkak se janë ata që në mënyrë direkte kanë përgjegjësi kujdesin ndaj fëmijëve, dhe kalimi i përronjëve sidomos gjatë periudhës së shirave, bën që fëmijët e tyre të jenë të rrezikuar qoftë edhe për të shkuar në shkollë. Gjithashtu mungesa e ndicimit në rrugë, bën që gratë dhe vajzat të jenë më të pasigurta jashtë shtëpive të tyre në orare të vona.

Në bashkinë Fushë-Arrëz ndër vite mbështetja për grupet në nevojë dhe për zbutjen e problematikave të jetesës jepet kryesisht nëpërmjet ndihmës ekonomike (NE) dhe pagesës për aftësinë e kufizuar (PAK). Ndërkohë, mungojnë shërbime të tjera të buxhetuara në mbështetje të riintegritit social dhe ekonomik të grave dhe vajzave viktime të dhunës në familje.

Gjithashtu, për shkak të kapaciteteve të kufizuara, ka qënë akoma më e vështirë integrimi i perspektivës gjinore në buxhetin vendor. Kjo lidhet edhe me mungesën e të dhënave të ndara sipas gjinisë lidhur me përfituesit e shërbimeve sociale pranë kësaj bashkie, gjë që ka vështirësuar kryerjen e një analize të plotë në terma të shpërndarjes së shpenzimeve buxhetore sipas nevojave të kategorive vulnerabël.

Referuar programeve buxhetore, vlen të theksojmë se programi kryesor buxhetor që për shkak të qëllimit dhe objektivave lidhet me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror është ai i "Kujdesit për Familjen dhe fëmijët", shpenzimet e të cilat janë planifikuar për shërbimet e çerdheve, kopshteve, qendrat e shërbimeve sociale vendore si edhe shërbimet sociale për shtresat në nevojë. Megjithatë, pavarësisht këtyre komponentëve ajo që evidentohet në analizë të buxhetit vendor të Bashkisë Fushë-Arrëz është se pjesa më e madhe e shpenzimeve të planifikuara për këtë program lidhen me mbështetjen financiare që bashkia ofron për pagesat e invaliditetit dhe paaftësisë si edhe shpenzimet për mbulimin me paga dhe sigurime shoqërore të personelit të bashkisë pjesë e sektorit të përkujdesjes sociale. Pavarësisht numrit të rasteve të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, nuk evidentohen në këtë programi buxhetor produkte specifike që lidhen me ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Gjithashtu, edhe në programet e tjera (psh arsimit) nuk janë parashikuar shpenzime buxhetore të dedikuara për rate dhe vajzat viktime të dhunës me bazë gjinore.

Në terma të prioriteteve të Bashkisë lidhur me progresin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, bazuar në informacionet shkresora nga Bashkia Fushë Arrëz evidentohet se prioriteti kryesor i bashkisë për vitin 2023 ka qënë përgatitja dhe miratimi i Planit Vendor për Barazinë gjinore. Gjithashtu, ndër objektivat politike të Bashkisë renditen:

- a) Ridimensionimi dhe strukturimi i sektorit të shërbimeve sociale në bashki në përputhje me ligjin për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror
- b) Rritja e efektivitetit të qasjes shumë sektoriale dhe shërbimeve bazë zë specializuara për viktimat, të mbijetuarat/it e dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit.

Për arritjen e këtyre objektivave, bashkia Fushë Arrëz ka planifikuar edhe realizimin e disa aktiviteteve gjatë 2023 si:

- Ngritja e Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel bashkie;
- Fuqizimi i kapaciteteve të Komisionit për Barazinë Gjinore lidhur me njohjen e rolit, detyrave dhe përgjegjësi të tij;
- Takime informuese me administratorët shoqërore për ndërgjegjësimin lidhur me rolin e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave vulnerabël në dëgjuesat publike dhe vendimmarrje vendore;
- Seminare trajnuese mbi integrimin gjinor etj.

Ndërkohë mungon planifikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe të tjera me fokus rritjen e ndërgjegjësimit të grave dhe vajzave viktime të dhunës në familje si edhe planifikimi i ofrimit të shërbimeve specifike gjinore për këto kategori.

Gjithashtu, ajo që duhet të nënvizojmë si problematike është mungesa e lidhjes midis prioriteteve politike në nivel bashkie dhe shpenzimeve buxhetore. Për ta konkretizuar, referuar dokumentit të buxhetit 2022, 2023 si edhe programeve buxhetore afatmesme brenda këtyre periudhave, asnjë prej aktiviteteve të sipërcituara nuk është planifikuar në aktivitetet e buxhetuara brenda buxhetit vjetor. Shumica e shërbimeve për grupet e marxhinalizuara janë financuar kryesisht nga donatorët me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile, gjë që shton nevojën për marrjen e masave me qëllim adresimin e nevojave të kategorive vulnerabël përmes buxhetit vendor.

Konstatimet e mësipërme janë evidentuar edhe më herët në kuadër të një studimi lidhur me fuqizimin ekonomik të grave rurale i kryer nga shoqata AgroPuka në vitin 2020. Sipas këtij studimi, theksohet se në bashkinë Fushë Arrëz ka mungesë të përgjigjes për nevojat e grave në zonë, si dhe efikasitet jo të mjaftueshëm të tyre nga ana e vendimmarrësve. Krijimi efektiv i politikave vështirësohet edhe nga mungesa e të dhënave, përfshirë krahasimet urbane/rurale, nivelin e arsimit me të dhënat gjinore. Për këtë arsye është vështirë edhe analiza gjinore thelbësore në shumë disiplina. Studimi më tej identifikon dy pengesa konkrete për zbatimin e politikave që përkrahin barazinë gjinore: (i) financimi jo i mjaftueshëm dhe jo i qëndrueshëm; dhe (ii) mungesa e një sistemi monitorues dhe vlerësues të efektshmërisë së politikave në veçanti ndikimi i tyre në jetën e grave të zonave rurale.

Përfundime dhe Rekomandime

Analiza e realizuar për efekt të këtij raporti nxorri në pah se:

- Bashkia ka një varësi të madhe nga të ardhurat nga buxheti qëndror, çka i pamundëson financimin e politikave vendore.
- Edhe nëse aksesohen burime, vëmendja është në përmirësime në infrastrukturë, si rrugë apo te tjera, dhe shumë pak vëmendje në përmirësim të shërbimeve sociale me fokus gratë dhe vajzat viktime të dhunës.
- Burimet njerëzore të dedikuara për mbrojtjen sociale janë të pamjaftueshme, por dhe të trajnuar për të ofruar/asistuar vetëm në disa shërbime bazë.
- Kapacitetet e ulëta të administratës vështirësojnë aksesin në programe nga donatorë të ndryshëm.

Me qëllim rritjen e mirëqënies të grave dhe vajzave në nivel të qeverisjes vendore evidentohet:

- Nevoja për përmirësimin e infrastrukturës rurale, të cilat do të mundësonin akses më të mirë dhe për ato pak shërbime që ofrohen nga bashkia.
- Përdorimi i buxhetit pjesëmarrës dhe mjeteve për përpilim të buxhetit duke marrë parasysh aspektin gjinor, me qëllim përmirësimin e plotësisht të nevojave të grave dhe burrave ruralë nga pushteti vendor.
- Përmirësimi i shërbimeve në përgjithësi, por veçanërisht ata të shëndetësisë dhe arsimit.
- Rritja e masës së pagesës për ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale, në me qëllim reflektimin sa më afër të nevojave
- Të përmirësohet infrastruktura e shërbimeve sociale duke shtuar ambiente për zyra dhe sigurimi i infrastrukturës përkatëse për personelin dhe personat në nevojë që kërkojnë shërbimet;
- Të ngrihen shërbime që sigurojnë monitorim të rasteve të dhunës me baze gjinore
- Të parashikohet në buxhet shtimi i stafit me punonjës që kanë kualifikimin e duhur për shërbimet që janë të parashikuara me ligj.

Në terma të aplikimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, për Bashkinë Fushë Arrëz vlejnjë rekomandimet e mëposhtme:

- Bashkia Fushë Arrëz duhet të marrë masa për të planifikuar në programet buxhetore të ardhshme objektiva specifike të ndjeshme gjinore brenda programeve të përkujdesjes sociale dhe kujdesit për familjen dhe fëmijët.
- Bashkia Fushë Arrëz duhet të mbledhë dhe analizojë të dhëna të disagreguara sipas seksit lidhur me përfituesit nga çdo produkt i realizuar për arritjen e objektivave të programeve buxhetore në fushën e shërbimeve sociale.
- Bashkia Fushë Arrëz duhet të marrë masa për realizimin e plotë të projekteve që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave viktime të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- Bashkia Fushë Arrëz të hartojë tregues të veçantë lidhur me numrin e grave dhe vajzave përfituese nga programi “Kujdesi për familjen dhe fëmijët”
- Bashkia Fushë Arrëz nevojitet të marrë masa për të rritur peshën që zenë në buxhetin vjetor programet e fokusuara në fushën e shërbimeve sociale me fokus të veçantë në planifikimin e shpenzimeve për shërbime të kujdesit shoqëror për gratë dhe vajzat viktime të dhunës.

Me zbatimin e këtyre rekomandimeve, Bashkia Fushë Arrëz mund të ndikojë në përmirësimin e jetës dhe integrimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave viktime të dhunës, duke bërë hapa të rëndësishëm drejt gjithëpërfshirjes, barazisë gjinore dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Referencat

1. Plani Social Bashkia Fushë-Arrëz 2021 – 2023
2. “Statusi i fuqizimit ekonomik të grave rurale në Rajonin e Pukës”, AgroPuka, 2020
3. Buxheti për qytetarin 2020-2023 <https://drive.google.com/file/d/1mAmE6Kl6e8Q77vD8lVvtwdLq7S9DDRGv/view>
4. <https://www.bashkiafushearrez.gov.al>

